





Jeni mashtruar?

Ende prisni një produkt që keni blerë në internet? Apo produkti që keni marrë nuk përputhet me atë që keni porositur? Atëherë mund të keni rënë pre e një mashtrimi.

Mashtrimet në internet po bëhen gjithnjë e më të sofistikuara. Ato ndodhin kur bëni një blerje nga një faqe interneti e rreme ose një reklamë e rreme në një faqe legjitime. Produkti mund të mos ekzistojë në të vërtetë, mund të jetë i falsifikuar ose mund të ketë cilësi të dobët.



Si të veproni?

1. Përpquni të **kontaktoni shitësin**, për të kuptuar arsyen e problemit me produktin tuaj.



2. **Kontakttoni** menjëherë bankën tuaj nëse:

- llogaria juaj bankare është kompromentuar
- vëreni një aktivitet të pazakontë në llogarinë tuaj të kartës së kreditit
- nuk merrni përgjigje ose nuk jeni të kënaqur me përgjigjen nga shitësi



3. **Ndryshoni fjalëkalimin.**

Mashtruesit në internet mund të kenë fjalëkalimin tuaj. Krijoni një fjalëkalim të fortë me të paktën 15 karaktere, duke përfshirë shkronja të mëdha dhe të vogla, numra dhe simbole.

Përdorni një **fjalëkalim unik** për secilën llogari.



4. **Përditësoni** antivirusin për të mbrojtur pajisjet tuaja nga viruset.



5. **Raportoni** mashtrimin.

Raportoni rastin tuaj pranë komisariatit më të afërt të policisë.



6. Ruani **çdo evidencë** që keni si psh. email, fatura, kopje të ofertave/reklamës etj.



7. **Ndani** eksperiencën tuaj me familjarët dhe miqtë tuaj për t'i ndihmuar ata në parandalimin ose adresimin e rasteve të ngjashme.

